

ANILA OMARI

**DUKURI ARKAIKE APO RISI? FORMIMI I KOHËS SË ARDHME
NË GJUHËN E GAVRIL DARËS**

Poema ‘Kënka e sprasëme e Ballës’ e poetit intelektual arbëresh Gavril Dara ka qenë nga veprat më të njohura e më të dashura të letërsisë arbëreshe në Shqipëri. Ajo ka njohur botime të shumta, kryesisht shkollore, dhe studime të karakterit letrar e filologjik. Një botim i mirëfilltë kritik i poemës dhe i teksteve të tjera të lëna nga Dara pa dritën e botimit në vitin 2007 nga filologu i shquar arbëresh Matteo Mandalà. Me këtë botim filologjik vepra e plotë e Darës na vjen në gjuhën origjinale, siç e ka folur dhe shkruar autori i saj. Me gjithë studimet e shumta rreth poemës dhe autorit të saj, gjuha e teksteve të Darës ka mbetur disi jashtë vëmendjes së studiuesve. Ndoshta i vetmi që na ka lënë disa shënime me interes për gjuhën e poemës është prof. Shaban Demiraj. E megjithatë, gjuha e Gavril Darës paraqet interes, pasi përfaqëson të folmen e Palac Adrianit, një nga fshatrat arbëreshe të Sicilisë, e folme e cila tashmë ka mbi njëqind vjet që ka humbur dhe është zëvendësuar nga italishtja.

Ne kemi bërë një studim për gjuhën e teksteve të Darës, në bazë të botimit kritik të Mandalait, i cili rindërton, mundësisht sa më pranë së vërtetës, sistemin fonetik që qëndron prapa sistemit grafik të përdorur prej tij.

Në këtë kumtesë do të përqendrohemi në një dukuri interesante të sistemit foljor të gjuhës së teksteve të Darës, që e dallon atë jo vetëm nga të folmet e tjera arbëreshe, por edhe nga ato të shqipes së përgjithshme. Kjo dukuri ka të bëjë me formimin e së ardhmes dhe pjesërisht të lidhore.

Siç dihet, të folmet arbëreshe e formojnë të ardhmen në dy mënyra: 1. me foljen ndihmëse *kam* + lidhore,¹ 2. me pjesëzën e ngurtësuar *do* + lidhore.²

Në tekstet e Darës këto dy mënyra janë pak të përfaqësuara. Për të shprehur kohën e ardhme Dara përdor trajtat e mënyrës dëshirore. Të njëjtat trajta shërbejnë edhe për lidhoren, krahas formave të lidhore së mbarë shqipes me pjesëzën *të*.

Meqenëse kjo dukuri që s’e kemi hasur gjëkund tjetër në letërsinë shqipe na ngjalli interes e kureshtje, e ndoqëm përdorimin e saj në të gjithë veprën e Darës, si në tekstet në prozë ashtu dhe në poemë, duke kryer vjelje të plota. Klasifikimi i shembujve nxori panoramën e mëposhtme të përdorimit të dëshirores në veprën e

¹ Në Horën e Arbëreshëve folja ndihmëse *kam* tashmë është ngurtësuar në vetën e tretë *ka*, khs.: Nesër *ka shërbesh?* - Jo! (Domani lavorerai? - No!), Kushedi që shi *ka bienj* sot! (chissà che pioggia cadrà oggi!); G. Gerbino, *Grammatica della parlata arbëreshe di Piana degli Albanesi*, Cesena, 2009, f. 109v., 121.

² Khs. edhe E. Çabej, *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë*, art. i cit., në: “Studime Gjuhësore” V, f. 82-83.

Gavril Darës. Trajatat e mënyrës dëshirore aty shprehin disa kuptime mënyrore e kohore:

1. Dëshirore e mirëfilltë me kuptimin themelor modal të dëshirës në formë urimi ose mallkimi: / *daft Perëndia* se të shuhet nëma e moçëme / “voglja Iddio...” Para-Th. 26, / Nāt e heljm *të pështroft* / I II 76 “Notte e dolore t’ avvolga”, / Gjith të shtuniet *arthëshin* / E shtunia e Shaljës ngë *arthët* kurr! / I II 79, / *Të përzëft* edhe moti / Dit e zezë, e pisëruame! / I II 80-81³.

a) Dëshirore-urdhërore: / Mbret! *Mos dafshe* të rëfikset / “non volere che appassisca” I IV 131, / Se këtë hërë *mos harrofshe* / Edhe Marës *kujtofshe!* / I IV 252-254 “Oh quest’ora non obliare / E di Mara rammentati!”, / Pra’ *kujtofshe* këto porsima: / “Poi ti sovviene di questi consigli” II I 355.

b) Dëshirore në fjali kushtore (nuk shpreh dëshirë por veprime të mundshme të së ardhmes): / *mos Arbreshët* e Eljinët *ndëljedheshin*, njerët tjerët, mëkatëzit tire, e *mënofshin* edhe ndār, si jan / “se Albanesi ed Elleni non si perdonassero, gli uni e gli altri, dei peccatucci loro, e rimanessero ancora divisi” Para-Th. 342-43, / Krëstënj e Maometân, Katoljîq e Orthodhoks që *të kljofshin* / “che fossero” Para-Th. 28, / Ndo, *të ardhët* një dit / E heljmuame ndë mōn / “Se mai t’avvenga un giorno / Doloroso nel tempo” I IV 252-53⁴.

2. Lidhore, formuar nga e tashmja e dëshirores me ose pa pjesëzën *të*⁵: / *ljër sa të zotroft* / “nata a dominare” Para-Th. 27, / edhe shtuar, sa *u bëfshin* si një kurm e një zëmër vet’ / “pure congiunti da formare un corpo ed un cuor solo” Para-Th. 251-53, me alternim të lidhore së zakonshme me lidhoren e shprehur me dëshirore: / Andaj isht ndë udhë, se gjërinj që jan, të shtonëshin e të përzihëshin bashk ndë vllamje, psë ashtu kumbisur, vëllau vëllaut, shoku shokut, *dëftofshin* dhëmbët qenëvet të huaj / “si congiungano e si confondano insieme in fraternità, perché così appoggiati il fratello al fratello, il compagno al compagno, mostrino i denti ai cani stranieri” Para-Th. 248-50, / *mos u gënjejshin* nga Papa i Rromës, e *të ruhëshin* priftërashit e kallogjërshit, që ai dërgon / “di non farsi ingannare dal Papa di Roma” 323-24, / Kurë *të raft* siuthi i ljum / “Quando ti cada l’occhio beato” I III 55, / E *t’arrëft* mera e ljljuevet / “E ti pervenga il profumo de’ fiori” I III 57.⁶

³ Shembuj të tjerë në: I III 7, I IV 103, I IV 106, I IV 109, I IV 171; I IV 249, II I 360, IV II 6-8, III II 88-92.

⁴ Shembuj të tjerë në: I IV 281-3, I IV 287-8, I IV 296, II I 296.

⁵ Krahës formave të dëshirores, lidhorja shprehet edhe me format e lidhore së mbarë shqipes, e paraprirë nga pjesëza *të*: *të vej* Para-Th.156, *të shuhet* 26, *t’e ndëljgonjën* 159, e *të ruhëshin* priftërashit e kallogjërshit, që ai dërgon 323-24, vjen-më-rār, sa *të mbanjën* ndār Arbrin, e *t’e nakatosënjën* “vuol dire per tenere disiva l’Albania e sconvolgerla” 211-12, *të përzihet* pra me gjith horët e katundet e tij, e *të shtrëngonet* “si unisca, poi, con tutte le regioni e città e si annodi in lega” 230-31, Sinani shërbenj *të dërtonj* e *të prier* ljtisht këngët e Serafinës Topies “Per ora lavoro per comporre e tradurre in italiano i canti di Serafina Topia” f. 362.

⁶ Shembuj të tjerë në: Para-Th. 186-7, 198, 204, 206-7, 255, 264, 311-12, 338, I II 12, I IV 119, I IV 177; I IV 293; I IV 314; I IV 316-319, I IV 332-335; Letër atit, 23 mars 1864, f. 362 rr. 8-9, rr. 20.

Dukuri arkaike apo risi? Formimi i kohës së ardhme në gjuhën...

a) lidhore-urdhërore: / Ec: *t'e ruashe* me ndër! / “Vanne: custodiscilo con onore!” II I 330.

3. E ardhme e mirëfilltë, e barasvlershme me të ardhmen e tipit *do të bëj* të mbarë shqipes: / edhe shtuar, sa u bëfshin si një kurm e një zëmër vet', po *kljofshin* pakëz e të vegjëljëz, mballa rreksevet e gji-tonis / “pure congiunti da formare un corpo ed un cuor solo, sempre saranno pochini e piccini, rimpetto ai giganti del vicinato” 251-253, / Çë do *kljē* Këmba-Maljit Italliotëve, *kljoft* edhe t'Arbreshëve e Maqedhoniotëve, Mbretëria Eljinëve / “Ciò che fu il Piemonte agli Italiani, sarà pure agli Albanesi ed ai Macedoni il Regno degli Elleni” 273-74, / *bëfshin* një të përzit gjasht miljunësh / “formerebbero una lega di sei milioni” 334, / *arrefit* ajo dit, por *kljoft* për tã, dit lji-pi e vaj, psë *rafshin* ndër duar aqë të rëndë e të bushtëra / “arriverà quel giorno, ma sarà per essi giorno di lutto e di lamento, perché cadranno tra mani tanto pesanti e crudeli” 344-45, / *Pafshë* atje, mballa ndeje / Biljën forëmen e Kaurit / I III 60 “Vedrai colà, di fronte a te / La figlia altiera del Caur”, / Por ndër vramje gjith mōn / *Vaft* zëmëra? / “Ma alla strage in ogni tempo / Andrà il cuore?” I III 149, / Kurë *t'u zbardhët* ata báll / “Quando ti s'incanutirà quella fronte” I IV 114, / *Raft* këputur stilli it / “Cadrà tronca la tua lancia” I IV 118⁷.

a) E ardhme deliberative: / Po si *kljoft*, se aī Arbër / “Or come avverrà, che quell'Albania” 228, / Mbret, çë *kljoft* aī zbardhëllim / “Oh che sarà quel migliore” III I 53.

b) E ardhme e përparme⁸: / M'u hap varri ndër vethë, / E më *vrafshe* pa ndër / “E mi uccideresti senza gloria” II I 111-2, / Sa do nxenet ndër shpërvier / Ish, sa gruaja *dëshëroft* / “Quanto contiensi nella tenda / Era quanto donna potesse bramare” II I 288-9, / u *dafsha* se Kënga e Ballës *kljoft* Arbëreshëve [...] / “Io vorrei che il Canto di Bala fosse agli Albanesi [...]” Para-Th. 178. Te Dara në një rast e ardhmja e përparme shprehet edhe me të kryerën e lidhore: / thomse edhe Arbri jin të *kish pasur* Omerëthin e tij / “forse anche l'Albania nostra avrebbe avuto l'Omeruccio suo” Para-Th. 197-8.

Në një masë shumë më të vogël janë përfaqësuar dy tipet e tjera të së ardhmes: e ardhmja me *do* dhe ajo me *kam*.

E ardhmja me *do*, pa ose me pjesëzën *të / t'*, përveç kuptimit kohor të së ardhmes, shpreh edhe disa kuptime modale:

a) e ardhme e mirëfilltë me kuptim prospektiv: / Ti, krie ljuftash i moçëm, / Po këtu stisur *do më gjësh* / “Ed agli orecchi giungerammi / ... / ... / Sempre più

⁷ Shembuj të tjerë në: I IV 121, I IV 173, I IV 209, I IV 239-40, I IV 252-254, I IV 274-5, I IV 281-3, I IV 291, I IV 293, I IV 323-327, I IV 332-335, II I 66-7, II I 318, IV II 265-268, IV II 273-277, IV II 281, I IV 268.

⁸ Kjo formë përdoret më fort për të shprehur veprime të mundshme të së shkuarës. Në këtë përdorim ajo është e barasvlershme me të kryerën e mënyrës lidhore, të prirë nga folja me vlerë modale *mund*. Khs. F. Agalliu, E. Angoni, Sh. Demiraj, A. Dhrimo, E. Hysa, E. Lafe, E. Likaj, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Morfologjia, red. Sh. Demiraj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 317.

fermo mi rinverrai” I IV 316-319, / Ndë ushtëri / *Dō’ sjëll* vashën? / “In campo / Condurrà la fanciulla? II I 318-19, / Illëthin bardh, çë *dō jët* / Drit e gaz sterëvet tãn / “La stella candida che sarà / Luce e gioia de’ pelagi nostri” III I 87-8, / Po *do vinj*, edhe *do rrônj* / “Verrà pure, e vorrà vivere” III II 88-92, / Se jũ t’urt, e far e shkljuame / *Do’ më jipëni* zgjëljedhësĩn / Kësaj nat plo-këshilli... / I IV 164-65-66 “Vorrete concedermi la scelta”.

b) e ardhme e domosdosë (me kuptimin e urdhërores): / të u kujtofshtin se besa e tire *do jët* një / “si ricordino che la fede loro deve essere una” Para-Th. 184-5.

c) e ardhme deliberative: / U llojas se ajo gëljuh ngë *de’ t’ish* tjetër se Arbreshja / “To credo che quella lingua non fosse altro che l’albanese” Para-Th. 243, / çë *do kljof*? / “Che sarà?” I IV 177 (me dëshirore), / Mbre! *do jet* mjegulla e ljumit / “Oh, sarebbe la nebbia del fiume” III I 45, / Ki pljāk, Haruni, *de’ t’ish* një Dervish / Shënime 165. Ky tip i së ardhmes përmban ngjyrimin modal të mundësisë (të gjasës a probabilitetit)⁹

Me *do* shprehet në ndonjë rast edhe **mënyra kushtore**: / se mos ai qasej horëvet e katundëvet tire, *de’ të mbahëshin* ndë një ān, pa më luftuar / “se egli non si accostasse alle città e regioni loro, si terrebbero in disparte, senza combattere più” Prapa-Th.41-42. Me mënyrën lidhore kushtoren e afron modaliteti i mundësisë.

E ardhmja me kam:

a) E ardhme e mirëfilltë, me kuptim prospektiv, me ose pa pjesëzën të: / nesër prana *ka dëftohet* / Kuj përkeft nderja e Ljaljës / I IV 173 “Domani poi svelerassi / A chi spetterà l’onore di Lala”, / E prā sē kē të *dimënoshë*. / “E poi non potrai svernare” Kënga e Zogut f. 268 v. 19, / Lazëri vëdiq e *kā të dalë* / “Lazzaro è morto, ma risorgerà” Këngë të shën Lazërit, f. 290, v.3, / Nga një varrë i gorromisur / *Kā të ngrihet llamparisur* / Këngë të shën Lazërit, f. 292, v. 45, / *Kā të mbëltonjē* gjithë ktë jet / “Si estenderà su questa vita” Këngë të shën Lazërit, 48. Në këto këngë të fundit (Kënga e Zogut dhe Kënga e Shën Lazërit) G. Dara ka ruajtur frymën e këngëve popullore, prandaj ato përmbajnë të ardhmen me *kam* karakteristike për të folmet arbëreshe.

b) E ardhme me ngjyrimin e domosdoshmërisë (futurum necessitatis): / do a mos, *kā të kumbiset* mbi gjitonët / “voglia o non (voglia) deve appoggiarsi sui vicini” Para-th. 204-5, / Por t’Arbreshët e Maqedhoniotët *kān të ndëljonjēn* / “Ma gli Albanesi e i Macedoni debbono comprendere” Para-Th. 251.

Pyetja që del së pari nga këto përdorime të trajtave të dëshirores është: ku e mori Gavril Dara këtë model? Ishte një përdorim i së folmes amtare të tij apo një krijim i gjuhës së tij letrare?

Në shkrimet e paraardhësit të tij të drejtpërdrejtë, Andrea Darës¹⁰, gjejmë një përdorim të vetëm të dëshirores me kuptim kushtor: / Po *në ti dafshe* rrefiesha /¹¹

⁹ Gramatika e gjuhës shqipe I, f. 316.

¹⁰ Kërkimi është bërë në dorëshkrimet e A. Darës nga botimi i F. De Miceli, *I manoscritti danesi di Andrea Dara*, vep. cit., dhe në një dorëshkrim të tij botuar nga M. Mandalà në

Dukuri arkaike apo risi? Formimi i kohës së ardhme në gjuhën...

të cilit i përgjigjet nga G. Dara *Ndo, ti e dafshe* I I 94 (khs. në gjuhën e sotme bisedore *në daç* “po deshe, po të duash”). Përndryshe në tekstet e mbledhura prej tij nuk dalin trajta të së ardhmes, të çfarëdo lloji tipi. Kjo shpjegohet pas gjase me faktin se dorëshkrimet e Andrea Darës përmbajnë këngë popullore, të cilat më tepër tregojnë ngjarje në kohën e tashme, të rrëfyera në një gjuhë të thjeshtë, karakteristike për gjuhën popullore.

Vetë Gavril Dara në letrat e tij vetjake dërguar prindërve e përdor në dy-tre raste trajtën e dëshirores. 1. Me kuptimin e lidhore: / kam shprës se, më të sosurit të moit që hin, qivernia *të më dhëft* thellim / “spero che, verso la fine del mese entrante, il governo mi dia licenza” Ljitra prindrvet, f. 362, rr. 8-9; / Po që do *kljoft* / “Comunque sia”, po aty, rr. 20. 2. Me kuptimin e së ardhmes: / Ngë ljothem për këtë e aqë dua të ljiç njera që më *dafshin* / ¹² “Non mi stanco di questo e tanto voglio chiedere sino a che non me lo concederanno” Ljitra prindrvet, f. 362, rr. 13. Përndryshe, për të ardhmen, Dara në këto letra përdor trajtat e së tashmes, khs.: / U e pres me kujdes, e si *m’arren t’e dërgonj*. U një dit nga kta, si të jem lëshuar, *vete* Bulonj e i *gjenj*. / “Io lo attendo con impazienza, non appena lo avrò, te lo spedirò. Io un giorno di questi, appena sarò licenziato, andrò a Bologna e lo troverò”, po aty, f. 364, rr. 5-6.

Qoftë edhe këta pak shembuj tregojnë se përdorimi i trajtave të dëshirores për të shprehur kuptimet e mënyrës lidhore e të kohës së ardhme ishte i pranishëm në të folmen amtare të Darenjve të Palac Adrianit.

Pikënisja e kësaj dukurie duhet kërkuar në përdorimin e dëshirores në fjalitë e nënrenditura kushtore me lidhëzën *në*, mjaft i vjetër në shqipe dhe me karakter mbarëshqiptar.¹³ Në këtë rast e tashmja e mënyrës dëshirore përdoret edhe për të shprehur veprime të mundshme të së ardhmes, pa shprehur dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi. Në këtë përdorim ajo është sinonime me të tashmen e lidhore. Siç kanë vënë në dukje gjuhëtarët indoevropianistë, afëria e madhe midis dëshirores dhe lidhore ka bërë që format e këtyre dy mënyrave të jenë përzier qysh herët në shumicën e gjuhëve i.-e.¹⁴ Afëria e lidhore me dëshiroren vjen nga vetë kuptimi themelor i foljes në mënyrën lidhore, i cili është të tregojë një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqit si të mundshme a të dëshirueshme.¹⁵ Pra këto dy mënyra foljore në një fazë më të hershme të shqipes duket të kenë qenë më afër njëra-tjetrës dhe janë përdorur njëra për tjetrën. Edhe nga ana formale këto

artikullin: *Për botimin kritik të “Kënkës së sprasëme të Ballës”*, ”Studime filologjike”, nr. 3-4, 2006.

¹¹ Khs. M. Mandalà, *Për botimin kritik të “Kënkës së sprasëme të Ballës”*, art. cit., f. 31.

¹² Në të dy rastet kemi kuptimin leksikor të foljes *jap*, prandaj ka më shumë të ngjarë që shkronja ò që Dara e përdor si për /d/ edhe për /dh/ këtu të lexohet /dh/, pra 1. *qivernia të më dhëft*, 2. *të ljiç njera që më dhafshin*.

¹³ Shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, botim i dytë i përmbledhur, përg. nga Bardhyl Demiraj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2015, f. 321.

¹⁴ Po ai, po aty, f. 311 me citim të literaturës përkatëse.

¹⁵ F. Agalliu, et al., *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, vep. cit., f. 321.

dy mënyra kanë të përbashkët formantin / -sh- / të trashëguar, që është ruajtur vetëm në vetën 2 nj. të lidhore. Në këtë vështrim del më i pranueshëm mendimi i Sh. Demirajt sipas të cilit burimi i formantit të dëshirores duhet kërkuar brenda paradigmes foljore të gjuhës shqipe, tek e kryera e thjeshtë e dëftores, nëpërmjet shtimit të mbaresave vetore të kohës së tashme të mënyrës lidhore.¹⁶

Që te Buzuku hasim dëshiroren me kuptimin e lidhore dhe jo vetëm të shoqëruar me ngjyrimin modal të dëshirueshmërisë, por edhe pa këtë ngjyrim modal:

1. / Gjithë Shenjëtitë e tū lusmë Zot, qi për gjithë vend ata na endimofshinë: ashtu qi për herë qi ata neve kur na *raftë* endë mend, për meritat të tyne na endiefshim endimënë e tyne. / (fol. 9r 75-78) “Omnes Sancti tui, quaesumus, Domine, nos ubique adjuvent: ut, dum eorum merita recolimus, patrocinia sentiamus” (Officium parvum B. Mariae Virginis. Commemoratio omnium Sanctorum).

2. / të lusmë neve na ep qi na kur *klofshim endiem* endë endimët të saj të pā endonjë faj na baftë. / (10r 13-15)

Shembujt e nënvizuar në trajtën e dëshirores (*raftë, klofshim endiem*) nuk kanë ngjyrim modal të dëshirës, por kuptimin kohor të së ardhmes. Këtë kuptim ka në gjuhën e sotme shqipe e tashmja e lidhore kur përdoret në fjali kryesore ose të pavarura.¹⁷ Në shqipen e vjetër është dëshirorja që përdoret me vlerën e lidhore në këtë kuptim kohor.

Mënyra lidhore mendohet se në zanafillë ka pasur edhe kuptim prospektiv, d.m.th. kuptimin e së ardhmes.¹⁸ Meqenëse gjuhët indoevropiane, sipas mendimit më të përhapur të studiuesve, nuk kanë pasur një formë të posaçme për kohën e ardhme,¹⁹ ato kanë zhvilluar mjete të tjera gjuhësore për këtë, kryesisht forma gramatikore që tregojnë qëllimin për të bërë diçka, nga të cilat mënyra lidhore e kishte këtë kuptim.²⁰ Gjuha shqipe, siç ka argumentuar së fundi Seit Mansaku²¹, ka ndjekur të njëjtën rrugë si gjuhët e tjera i.-e., duke përdorur trajtat e mënyrës lidhore për të shprehur të ardhmen. Gjurmët e fundit të këtij përdorimi i ndeshim te Buzuku, me veçorinë e tij karakteristike e deri tani unike në traditën e shkrimit të shqipes, të përfaqësuar në shembullin e mëposhtëm nga Pasthënia e tij: / përse ju kini me gjegjunë ordhëninë e Tinëzot: e atë në embarofshi, Zotynë të

¹⁶ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, vep. cit., bot. 2015, f. 314.

¹⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, vep. cit., f. 323.

¹⁸ P.sh. Brugmanni (1916, 835) dallon tri kuptime të lidhore i.-e.: 1 kuptimin volitiv ose voluntativ, 2 kuptimin deliberativ (në pyetje, nëpërmjet të cilave pyetet për ç’duhet bërë a ç’duhet të ndodhë), 3 kuptimin prospektiv, nëpërmjet të cilit shprehet një parashikim. Khs. Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, vep. cit., bot. 2015, f. 303.

¹⁹ Khs. Sh. Demiraj, vep. cit., f. 315 me literaturë.

²⁰ S. Mansaku, *Rreth tipologjisë dhe kronologjisë së trajtave të së ardhmes në gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2011, f. 59 me citim literature.

²¹ S. Mansaku, *Rreth tipologjisë dhe kronologjisë së trajtave të së ardhmes në gjuhën shqipe*, art. i cit., f. 56-60; Po ai, *Historia e kohës së ardhme në gjuhën shqipe në dritën e të dhënave të ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut*, “Studime filologjike”, nr. 3-4, 2005, f. 27-34.

Dukuri arkaike apo risi? Formimi i kohës së ardhme në gjuhën...

ketë mishërier embi jū / 90v50-51 =110v51. Ishte Martin Camaj ai që e vuri re së pari këtë dukuri të Buzukut si një të ardhme të vjetër të ruajtur në gjuhën kishtarë tradicionale shqipe dhe e quajti me largpamësi lidhore-dëshirore.²² Lidhjen midis kohës së ardhme dhe dëshirores e kanë vënë re gjuhëtarët indoevropianistë, si p.sh. K. Brugmanni, i cili ka shprehur mendimin se futuri sigmatik i indoiranishtes, i greqishtes, i italikishtes, i keltishtes e i sllavishtes ka të ngjarë të ketë qenë një deziderativ i vjetër.²³

Mënyrat lidhore e dëshirore, dhe më tej edhe kushtorja me urdhëroren, afrohen me njëra-tjetrën nga modaliteti i mundësisë. Ato shprehin veprime, kryerja e të cilave në të ardhmen objektivisht nuk është e sigurt, po vetëm e mundshme.²⁴

Gjuha e teksteve të Gavril Darës na dëshmon tani se Buzuku nuk ishte i pashoq në përdorimin e tij të së tashmes së lidhore me vlerën e së ardhmes. Të paktën një rast i sigurt në poemën e tij na e vërteton këtë: / Ndomos, raft ndër harë / Bumbullima, e gjaku i shprishur / *Të më ljanj* (= do të më lajë - A.O.) e tries e dark / I IV 156-158, “Altrimenti piomberà tra la gioia / Il fulmine e il sangue disperso / *Laverà le mense e le cene*”.

E përbashkëta e Buzukut dhe e Darës, përndryshe pa asnjë njohje i dyti ndaj të parit, është përdorimi i lidhore, përkatësisht dëshirores, me kuptimin kohor të së ardhmes. Këta dy autorë, në distancë kohore prej tre shekujsh mes tyre, i bashkon kjo dukuri e shqipes së vjetër paraletrare, e papërsëritur në traditën e shkrimit shqip dhe e ruajtur si një fosil gjuhësor te poeti arbëresh, i cili e vuri në përdorim sistematik dhe e përhap në gjuhën e tij letrare.

²² Martin Camaj, *Il Messale di Gjon Buzuku*, Roma, 1960, f.42-43; S. Mansaku, *Rreth tipologjisë dhe kronologjisë së trajtave të së ardhmes në gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2011, f. 58.

²³ K. Brugmann, *Grundriss II* f.338 v.; khs. S. Mansaku, art. i cit. f. 60. Po kështu mendon edhe A. Meillet, *Einführung in die vergleichende Grammatik der Indogermanischen Sprachen*, B.G. Teubner, Leipzig und Berlin, 1909, f. 125, sipas të cilit ndërtimet me -s- të futurit në disa gjuhë i.-e. kanë pasur pas gjase kuptim dëshiror në indoevropianishten e vjetër.

²⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, vep. cit., f. 273; Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*, vep. cit., bot. 2015, f. 255.

